



EHEAROME2020

---

# Komunikata Ministore Romë

---

SHTOJCA I



EUROPEAN  
Higher Education Area



bologna  
process



ITALIAN **BFUG** SECRETARIAT  
2018-2020



## **Deklaratë për lirinë akademike**

---

Ky tekst, i përpunuar nga BFUG në konsultim me një sërë ekspertësh dhe organizatash të palëve të interesuara, synon të përshruaj të kuptuarit e përgjithshëm të lirisë akademike për ZEAL dhe të ofrojë një bazë për zhvillimin e treguesve në të ardhmen.

Liria akademike është një aspekt i domosdoshëm i të nxënies, mësimdhënies dhe kërkimit cilësor si në arsimin e lartë ashtu edhe të demokracisë. Është një kusht i domosdoshëm që institucionet e arsimit të lartë të prodhojnë dhe transmetojnë njohuri si një të mirë publike në dobi të shoqërisë. Ajo u garanton akademikëve dhe studentëve lirinë e mendimit dhe kërkimit për të favorizuar njohuritë nëpërmjet kërkimit dhe për shkëmbyer lirshëm/hapur, si dhe lirinë për të komunikuar rezultatet e kërkimeve brenda dhe jashtë kuadrit të institucioneve dhe programeve akademike.

Liria akademike është një e drejtë e veçantë, themelore dhe demokratike e bazuar pjesërisht në të drejtën për arsimim, dhe ndan elemente me lirinë e mendimit, opinionit dhe shprehjes. Liria akademike duhet të kufizohet me standarde shkencore dhe profesionale rigorozë, respektimin e së drejtave të të tjerëve, sjelljen etike dhe ndërgjegjësimin për ndikimin e kërkimit mbi njerëzit dhe mjedisin e tyre. Është thelbësore për të avancuar standardet e disiplinave akademike dhe fushat e kërkimit. Si e tillë, liria akademike mbron jo vetëm diturinë dhe shprehjen individuale, por edhe funksionimin e lirë të institucioneve akademike në shoqëritë demokratike. Autonomia institucionale është konstituive për lirinë akademike.

Liria akademike përcakton lirinë e komunitetit akademik - duke përfshirë stafin akademik dhe studentët – në respektimin e kërkimit, mësimdhënies dhe nxënies dhe, më gjerësisht, shpërndarjen e rezultateve të kërkimit dhe mësimdhënies si brenda dhe jashtë sektorit të arsimit të lartë. Në thelb koncepti siguron që komuniteti akademik mund të angazhohet në kërkime, mësimdhënie, nxënie dhe komunikim në shoqëri pa frikën e masave ndëshkimore/hakmarrjes.

Liria akademike është gjithashtu një element thelbësor i demokracisë. Shoqëritë nuk mund të jenë vërtet demokratike pa respektuar lirinë akademike dhe autonominë institucionale. Në të njëjtën kohë, vlerat themelore të ZEAL nuk mund të realizohen plotësisht përveçse në shoqëritë demokratike. Liria akademike është e ngjashme me lirinë e shprehjes dhe është e vetdijshme/informuar nga standardet e disiplinave akademike si dhe ofron kushtet për të sfiduar këto standarde duke u bazuar në rezultatet e kërkimit.

Koncepti, edhe pse në dukje i thjeshtë, në realitet është shumë kompleks dhe i ndërlikuar me të tjera vlera themelore si autonomia institucionale dhe përgjegjësia publike për dhe e arsimit të lartë. Liria akademike është një vlerë universale e rrënjësor në kërkimin e dijes dhe të së vërtetës. Parimet e saj thelbësore nuk mund të kuptohen dhe interpretohen ndryshe në kontekste të ndryshme kombëtare ose lloje të institucioneve të arsimit të lartë. Por liria akademike nuk është një vlerë absolute dhe ushtrimi i saj merr formë në institucionet në të cilat punojmë dhe shoqëritë në të cilat jetojmë. Kështu diapazoni i sjelljes dhe kufijtë e kërkimit dhe të shprehjes që mbron liria akademike janë shpesh burim debati.

Liria akademike mund të kuptohet se përfshin lirinë për të nxënë, për të mësuar dhe për të hulumtuar, me secilën prej tyre që përfshijnë lirinë për të menduar, për të pyetur dhe për të ndarë idetë, brenda dhe jashtë sektorit të arsimit të lartë. Të dhënit kuptim dhe jetë këtyre lirive në realitetin e mjedisit akademik hap automatikisht një sërë çështjesh. Liria e mësimdhënies mund të realizohet konkretisht vetëm me përgjegjësinë publike dhe sociale si dhe autonominë institucionale. Autoritetet publike kanë përgjegjësinë për të siguruar që programet relevante të arsimit të lartë u

ofrohen qytetarëve, ndërsa institucionet autonome të arsimit të lartë marrin përgjegjësinë e madhe për kërkimin me programet që mbështetin, dhe për mënyrën se si mësohen keto programe. Stafit akademik gjithashtu ushtron një përgjegjësi të fortë në përcaktimin e kurrikulës dhe komponentëve të programit, si dhe zhvillimin e metodave të mësimdhënies të përdorura.

Qeverisja e arsimit të lartë gjithashtu ka një ndikim në liritë për të nxënë, për të mësuar dhe për të hulumtuar, dhe duhet të jetë organizuar me vetëdije në mënyra që respektojnë lirinë akademike. Në Evropë bashkëjetojnë modele të ndryshme qeverisjeje me staf akademik dhe studentë të përfaqësuar në organet qeverisëse dhe vendimmarrëse sipas këtyre modeleve. Pjesëmarrja në organet drejtuese mund të favorizojë misionet mësimore dhe kërkimore të institucionit dhe mund të pasqyrojnë qëllimin e angazhimit më të gjerë shoqëror. Cilido qoftë modeli i veçantë, personeli akademik dhe studentët duhet të marrin pjesë plotësisht në proceset vendimmarrëse dhe kanë të drejtë të shprehin pikëpamjet e tyre mbi politikat e institucionit të tyre dhe prioritetet pa frikë nga marrja e masave/hakmarrja. Vlerat janë të ndërlidhura dhe liria për të dhënë mësim ngre gjithashtu pyetjen se kujt i duhet dhënë mësim dhe kështu lidhe ngushtë me lirinë për të mësuar. Nga ana tjetër, këto vlera lidhen me aksesin e barabartë, me një sërë çështjesh mbi kriteret dhe kushtet për akses në arsimin e lartë që duhet të adresohen përmes dialogut shoqëror dhe procedurave administrative.

Në mënyrë të ngjashme, duhen bërë pyetje edhe për ata që bëjnë mësimdhënien dhe kërkimin, dhe llojin e procesit ekzistues të vendimmarrjes për rekrutimin dhe kohëmbajtjen e stafit akademik. Thelbësore është të sigurohet që personeli akademik përfiton nga kushte mjaftueshëm të sigurta punësimi për të qenë në gjendje të ushtrorë lirinë akademike. Stafit akademik nuk duhet të pësojnë kurrë kërcënime, shkarkime ose sanksione të tjera që lidhen me përmbajtjen e kërkimit, mësimdhënies ose deklaramit të pikëpamjeve të tyre profesionale.

Liria e kërkimit përfshin të drejtën, në përputhje me standardet profesionale të disiplinës përkatëse, për të përcaktuar: çfarë duhet (ose jo) të hulumtohet; si do të hulumtohet; kush do të hulumtojë, me kë dhe për çfarë qëllimi do të ndiqet kërkimi; metodat me të cilat, dhe metodat përmes të cilave, gjetjet e kërkimit do të shpërndahen.

Këto pyetje nuk mund të trajtohen në boshllëk. Përcaktimi i programeve ose disiplinave kërkimore të ofruara nga çdo institucion është një çështje komplekse që përfshin autoritetet dhe institucionet publike në zgjedhje të vështira, strategjike. Hulumtimi kërkon financim – i cili mund të vijë nga burime publike dhe private – dhe në shumë raste gjithashtu kërkon shqyrtim të kujdesshëm të çështjeve etike.

Edhe pse liria akademike është thelbësore për arsim të lartë cilësor, ajo nuk është një vlerë që mund të supozohet automatikisht. Ndërveprimi i elementeve dhe kushteve të ndryshme, që sigurojnë që liria akademike është operacionalizuar, duhet të ndërtohet sa më mirë, vlerësuar rregullisht, mbrojtur dhe promovuar.



**Co-funded by  
the European Union**

This translation is co-funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or the European Education and Culture Executive Agency (EACEA). Neither the European Union nor EACEA can be held responsible for them.





EUROPEAN  
Higher Education Area

